



# GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PARAQITJA E NJË REKURSI NË SHKALLËN MË TË LARTË GJYQËSORE

GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË QËNDRON NË MAJËN E E PIRAMIDËS GJYQËSORE. AJO SIGURON DHËNIEN E BARABARTË DHE TË PAANSHME TË DREJTËSISË PËR TË GJITHË QYTETARËT NË VEND DHE VENDOS STANDARDET E NJË GJYKIMI TË DREJTË. GJYKATA E LARTË E USHTRON PUSHTETIN NË PËRPUTHJE ME PARASHIKIMET KUSHTETUESE DHE LIGJIN. AJO SHQYRTON REKURSET KUNDËR VENDIMEVE TË GJYKATAVE TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DHE GJYKATAVE TË POSAÇME TË SHKALLËVE MË TË ULËTA, ME MISIONIN E VETËM QË TË SIGUROJË NJËSIMIN DHE ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË PRAKTIKËS GJYQËSORE.

## SI TË PARAQISNI NJË REKURS NË GJYKATËN E LARTË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në paraqitjen e një rekursi në Gjykatën e Lartë, duhet të ndiqni një sërë hapash.

### KËRKONI KËSHILLË LIGJORE NGA NJË AVOKAT

Vetëm një anëtar i licencuar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, mund të paraqesë rekurs në Gjykatën e Lartë. Personat që nuk janë avokatë, nuk mund të paraqesin rekurs dhe as të përfaqësojnë apo të mbrojnë veten në Gjykatën e Lartë.

**Shënim i rëndësishëm:** Kërkoni këshillim ligjor sa më herët dhe kushtojini vëmendje afateve. Nëse ju nuk arrini të respektoni afatet e përcaktuara ligjore, atëherë rekursi nuk do të pranohet nga gjykata ku ai depozitohet.

### NDIHMOJENI AVOKATIN TUAJ PËR TA DEPOZITUAR ÇËSHTJEN TUAJ

Avokati juaj do ta depozitojë rekursin në gjykatën që ka dhënë vendimin që ju dëshironi të kundërshtoni. Është gjykata ku depozitohet rekursi, e cila dërgon dosjen në Gjykatën e Lartë, pasi ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha afatet për dërgimin e saj.

**Shënim i rëndësishëm:** Pagesa e tarifave gjyqësore (tarifat e gjykatës) duhet të diskutohet me avokatin tuaj, para momentit të depozitimit.

### GJYKATA REGJISTRON ÇËSHTJEN TUAJ

Pasi Gjykata e Lartë të regjistrojë çështjen tuaj, nëpërmjet sistemit elektronik të çështjeve gjyqësore, çështjes do t'i caktohet një numër regjistrimi si edhe gjyqtari relator. Ju mund ta ndiqni statusin e çështjes tuaj në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, duke përdorur këtë numër, ose emrin e palëve në proces.





# GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

## PARAQITJA E NJË REKURSI NË SHKALLËN MË TË LARTË GJYQËSORE

### GJYKIMI ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR

Në rast se ju kërkoni përsheptimin e shqyrtimit të çështjes suaj në Gjykatën e Lartë, për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin, pala duhet të paraqesë kërkesë me shkrim drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila i përcillet gjyqtarit relator.

Kur kërkesa e palës për përsheptimin e shqyrtimit të çështjes vlerësohet e bazuar, gjyqtari relator, vendos pranimin e saj. Në varësi të ngarkesës dhe të urgjencës së çështjes, vendoset edhe intervali kohor brenda të cilit çështja do të planifikohet në kalendarin e shqyrtimit të çështjeve.

### KËSHILLTARI LIGJOR

Këshilltari ligjor analizon çështjen, harton një opinion këshillues (relacion) dhe më pas, ia kalon relacionin gjyqtarit, të cilit i është caktuar ajo çështje.

### NJOFTIMI I PALËS PËR DATËN E SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJES

Pas planifikimit të kalendarit të gjykimit të çështjeve nga ana e gjyqtarit relator, në respektim të afateve për publikimin e listave të shqyrtimeve në dhoma këshillimi dhe seanca gjyqësore, sekretaria gjyqësore afishon listat në ambientet e gjykatës si edhe i publikon ato në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

Këto njoftime përmbajnë: datat e shqyrtimit, oraret, palët dhe gjyqtarin relator të kolegjit përkatës.

### NË PRITJE PËR TË MËSUAR MBI ÇËSHTJEN TUAJ


Në intervalin ndërmjet momentit kur një çështje depozitohet dhe momentit kur ju merrni njoftim nga gjykata për një seancë të planifikuar, gjithmonë duhet të kërkoni informacion apo përditësim drejtpërdrejt nga avokati juaj. Megjithatë ju mund të aksesoni direkt faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, për të marrë informacionin e nevojshëm.


Në rastin kur avokati juaj nuk mundet t'ju ndihmojë dhe ju nuk keni mundësi të aksesoni faqen zyrtare, kontaktoni gjykatën me të dhënat si më poshtë:


### KONTAKTONI GJYKATËN


Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë

 Rr. Ibrahim Rugova Tiranë, Shqipëri

 +355 4 2257304

 [ida.vodica@gjykataelarte.gov.al](mailto:ida.vodica@gjykataelarte.gov.al)

 [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al)

 <https://www.facebook.com/GjykataeLarte>

 <https://www.linkedin.com/company/gjykata-e-lartë-e-republikës-së-shqipërisë/>